

Nr. 2740/4 Prot.

Durrës, më 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 147, Datë 21.11.2025

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL NË "KULTURË DHE KOMUNIKIM NDËRGJUHËSOR", PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin e UAMD-së neni 5, neni 15, neni 59; në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FE, si dhe në relacionin Nr. 2436/1 prot., datë 19.11.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Kulturë dhe Komunikim Ndërgjuhësor", pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqip, Anglisht dhe Gjermanisht.**

3. Kodi i programit të studimit: **72MP0288S**.
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

